



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:180805
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05385524

E.nr.678/2009

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Divizioni Civil, e përbërë nga gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen përmbarimore të kreditorit S.A.G nga Gjakova, kundër debitorit L.N.T nga Rahoveci, për shkak të ekzekutimit të pasurisë së paluajtshme, jashtë seance, më 28.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET se propozimi i kreditorit S.A.G nga Gjakova, në lidhje me këtë çështje juridike është TËRHEQUR.

A r s y e t i m

Gjykata me kërkesën për verifikim – sigurimin e adresës prej datës 14.08.2023, i është drejtuar Stacionit të Policisë në Rahovec, që sipas evidencave të tyre të vërtetojnë nëse debitori L.N.T nga Rahoveci, jeton apo ku gjendet në Kosovë apo gjetiu, apo nëse ju keni informacione me tepër për këtë palë, me qëllim që gjykata të vazhdojë me procedurat sipas ligjit. Stacioni i Policisë në Rahovec, me parashtrësën e saj Nr. i Ref.05/03-07/R:423/23, prej datës 19.09.2023, e ka njoftuar gjykatën se gjatë verifikimit dhe kontaktit me banor në lagjen e epërme të qytetit ka kuptuar se i njëjti nuk jeton në qytetin e Rahovecit dhe po ashtu nuk dihet saktë adresa e tij e banimit.

Kreditori edhe pse konkluzionin e datës 19.01.2024, e ka pranuar, i njëjti nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 102.3 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit, duke konsideruar se propozimi i kreditorit është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
E.nr.678/2009, më: 28.02.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.